



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Elbasan, më . . .2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Sigurimin e ujit për blegtorinë”

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – sherbim”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 77200000-0 - Shërbime pyjore

VLERA E FONDIT LIMIT 1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa t.v.sh.

Ne bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 9;

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit nr.08, date 23.09.2024, të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 9;

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifatat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrate tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, referuar nenit 42 pika 3, 43 pika 2/c dhe nenit 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të shërbimeve të realizuara,

ose

b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune, "Çertifikatë profesionale të ekspertit", për kategorinë përkatëse, referuar V.K.M nr. 288, datë 29.04.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, kritereve për pajisjen me çertifikatë eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave”, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për 3 mujin e fundit.

Argumentimi. Kriteri 2.3.2 është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe V.K.M nr. 288, datë 29.04.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, kritereve për pajisjen me çertifikatë eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të shërbimit objekti të prokurimit

2.3.3 - Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës .Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që kanë në dispozicion, të cilat janë si më poshtë vijon:

Lloji i Makinerive	Njesia	Sasia
Kamion me kapacitet mbajtës min 7 ton	copë	1

Për mjetet që regjistrohen në regjistrin publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumentet e mesipërme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale përkatëse të qirës, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti i këtij prokurimi.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, nenit 42 pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Kërkesa për disponimin e automjetit është në përputhje me zërat e preventivit: Transport auto gure, 18 km për kryerjen e transportit të gureve që do të përdoren për ndërtimin e leres në gastren pyjorë nr. 100/b të ekonomisë pyjorë, Polis Vasjan.

2.3.4 Një punësim mesatar prej **6** (gjashtë) personave, për 3 muajt e fundit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e punonjësve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi. Kërkesa është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit objekt të prokurimit e, që kanë në dispozicion apo që mund të vihen si dhe gjithashtu të kenë kualifikimet e nevojshme për realizimin e shërbimit.

Në përcaktimin e numrit mesatar të punonjësve prej **6** (gjashtë) punonjës, janë analizuar:

Kryerjen e aktivitetit të përmirësimit të fondit pyjor.

Duke marrë në konsideratë preventivin e miratuar për kryerjen e aktivitetit të ndërtimit të leres së ujit për blegtorinë, operacionet e punës, sipas zërave të punimeve të planifikuara në preventiv, bëjmë këtë përlllogaritje:

Bazuar në aktet ligjore në fuqi për normimin e aktivitetit të punës, një punonjës gjatë një muaji duhet të punonjë 21.75 dit/punë, ndërsa paga për ditë pune është përlllogaritur 1839 lekë (bazuar në pagën minimale mujore prej 40 000 lekë).

Meqenëse ndërtimi i leres është parashikuar të ndërtohet për një periudhë kohore **7 mujore** (periudha kryesisht pa reshje e cila nuk pengon kryerjen e punimeve të ndërtimit të leres).

Analizojmë me rradhë zërat e punimeve të planifikuara në preventivin e miratuar të ndërtimit të leres:

1- Germim dheu e transport k. dore 10 m, kat III. Janë parashikuar në planin e punës 3 muaj x 21.75 dip pune/puntor = 65,25 dit pune/muaj. Për këtë operacion janë planifikuar 449667,15 Lekë : 1839 lekë/dit pune = 244,5 dit pune : 65.25 dit pune/punëtor = 3.75 puntorë ~ 4 punëtorë.

2- Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme, janë planifikuar 41873,68 Lekë : 1839

lekë/dit pune = 22,8 dit pune : 87 dit pune/ 4 punëtor në 1 muaj = 0, 26 muaj.

3- Shtrim plasmasi në dy shtresa, janë planifikuar 41300 Lekë : 1839 lekë/dit pune = 22,5 dit pune : 87 dit

pune/4 punëtor në 1 muaj = 0, 25 muaj.

4- Shoshje dheu për shtrim mbi plasmas, janë planifikuar 23600 Lekë : 1839 lekë/dit pune = 12,8 dit pune :

87dit pune/4 punëtor në 1 muaj = 0, 15 muaj.

5-Transport dheu me tezgë 10 ml (2 punëtor), shtrim mbi plasmas, janë planifikuar 17700 Lekë : 1839

lekë/dit pune = 9,6 dit pune : 87 dit pune/4 punëtor në 1 muaj = 0, 11 muaj.

6-Hedhje, ngjeshje dheu me tokmak 20 cm trashësi. Kateg.e IV. janë planifikuar 40229,74 Lekë : 1839

lekë/dit pune = 21,9 dit pune : 87 dit pune/4 punëtor në 1 muaj r = 0, 25 muaj.

7-Prodhim gurë kave, janë planifikuar 108392,86 Lekë : 1839 lekë/dit pune = 58,9 dit pune : 87 dit

pune/4 punëtor në 1 muaj = 0, 68 muaj

8-Transport gurë me k.d deri 50 ml, janë planifikuar 28400 Lekë : 1839 lekë/dit pune = 15,4 dit pune

: 87 dit pune/4 punëtor në 1 muaj = 0, 18 muaj.

9-Transport gurë me tezgë 20 ml për bërje kalldrëmi, janë planifikuar 19880 Lekë : 1839 lekë/dit pune =

10.8 dit pune: 87 dit pune/4 punëtor në 1 muaj = 0, 12 muaj.

10-Shtrim kalldrëmi, 20 cm lartësi, janë planifikuar 265500 Lekë : 1839 lekë/dit pune = 144,4 dit pune :

87 dit pune/4 punëtor në 1 muaj = 1,66 puntor ~ 2 muaj.

Pra nga analizimi i zërave të punës sipërcituar dhe përlogaritjet respektive për secilin zë kemi këtë situatë përfundimtare:

-Nevojiten **4 punonjës** për realizimin e punimeve të zërit nr. 1 për një periudhë kohore prej 3 muaj, nga zëri nr 2 -10 do të realizohet për një periudhë kohore prej 2 muaj dhe për zërn nr. 10 ky numër punonjësish e realizojnë për 1.7 muaj apo rreth 2 muaj.

11- Transport auto gurë, 18 Km ; janë planifikuar 71 m³ : 5 m³/mjet/dit = 14.2 dit pune. : 21.75 dit pune/1 muaj = 0.7 muaj.

Mbas rivlersimit të numurit të puntorëve, "Investim në ndërtim lerë uji, për blegtorinë", duhen:

- 4 punonjës për kryerjen e punimeve
- 1 shofer kamioni për transportin auto të gurëve për shtrim.
- 1 Drejtuesi Teknik.

TOTAL : 6 punonjës

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

NJESIA E PROKURIMIT

Ardiana Merko

Oltion Kokunja

Hasan Idrizi